

# RAPORTI PARAPRAK

## I

### VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

#### TE AKTIVITETIT:

##### “PRODHIM BETONI”







**Subjekti: "BETONPLUS COMPANY" sh.p.k**

**Vendndodhja: Fshati Tale, Lezhe**

**Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k**

**Tirane, 2015**

# **PERMBAJTJA**

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

## **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

## **4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

## **6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrushem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

### **“Prodhim betoni”**

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

**Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.** Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislativ dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

### **“Prodhim betoni “**

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### **➤ Profili i propozuesit**

Subjekti "BETONPLUS COMPANY" sh.p.k e ushtron aktivitetin ne Tale, Lezhe.

### **1.1 Qellimi i projektit**

Subjekti "BETONPLUS COMPANY" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin e tij ne fshatin Tale, Lezhe per prodhim betoni per ndertimin e kompleksit te vilave te subjektit Margis-Italia sh.p.k. Ky impiant prodhim betoni do te jete i instaluar perkohesisht,deri sa te perfundojne punimet per ndertimin e kompleksit te vilave.

### **➤ Përshkrimi i Subjektit**

Materialet inerte qe sillen me kamiona vendosen ne bunkerin e ngarkeses. Shinat me siper mundesojne zgjedhjen e pare mekanike duke vecuar ndarjet me te medha se 250 mm. Materiali 0-250 mm me transportier furnizues eshte vendosur ne rripin transportues kryesor qe do te dergohen en site. Sita kryen seleksionimin e dyte duke i ndar enga madhesia me e vogel se 50 mm, deri ne ate me te madhen 250 mm. Ndarja me e vogel se 50 mm dergohet ne sitene radhes per zgjedhje perfundimtare ndersa ajo me permasa me te medha futet ne site per thyerje. Materiali i thyer mund te ndjek dy rruge mund te rikthehet ne site per thyerje ose te shkarkohet si nje produkt i fundit i quajtur stabilizant.

Produktet ndahen”

- Rere natyrore 0-8 mm
- Granil 1      8-16 mm
- Granil 2      16-28 mm
- Stabilizant    >28 mm

Rera natyrore eshte lare nepermjet makinerise larese/tharese dhe ben stokazhin (ruajtjen) nepermjet rripit te transportierit ne grumbullin e caktuar. Granili 1 dhe 2 si dhe stabilizanti produkte te perfunduara nepermjet shiritave transportues i bashkohen grumbullit te caktuar.

Uje qe perdoret per larjen e materialeve inerte kalon ne vaskat e dekantimit. Nga vaska e trete qe mban ujin me te paster uji perseri me ane te nje pompe dergohet serish ne procesin e larjes se inerteve. Vaskat kane gjatesi e para 12 m, e dyta 15 m e treta 13 m, gjeresia e tyre eshte 6.2 m dhe thellesia 5 m.

Pajisjet qe perbejne impiantin jane :

- Kazan ngarkese me site kontrolli me nje kapacitet 35 m<sup>3</sup>.
- Ushqyes transportieri nga 650 mm.
- Rrip transportues me gjeresi 800 x 24 000 mm me mbeshtetje motorike 15 HP.
- Frantoje e mesme me strukture mbeshtetje te plote, hapesine inspektimi, shkallet, transportues ngarkim- shkarkim, dhe motor 75 HP.
- Transportues me rrip i kthyeshem e vendosur nene siten vibruese dhe frantojen.
- Rrip transportieri me rrota per grumbullimin dhe ruajtjen e materialit te grimcuar.
- Rrip transportieri radhes, site rrotulluese.
- Site e radhes me tambur dhe llamarine me vrima per perzgjedhjen
- Pajisje larese/ tharese reku[peruese per rere e kompletuar me spirale vida dhe transmetim me motor.
- Rrip transportues per grumbullimin dhe ruajtjen e granilit 1.
- Rrip transportues per grumbullimin dhe ruajtjen e granilit 2.

### **Lenda djegese**

Proçesi nuk perdore lende djegese. Vetem perdorin mjetet e ngarkim-shkarkimit sipas normativave dhe kohes se punes, e cila eshte 6 dite ne jave vetem me nje nderrese.

## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

- **Trashegimia kulturore**

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures . Ne zonen ku ndodhet veprimtaria nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

- **Relievi**

Relievi i rajonit është i ndryshëm në pjesën perëndimore është fushor me kuotë të ulët mbi nivelin e detit dhe në pjesën lindore është kodrinor – malor në të gjithë zonën e fshatrave të malësisë në një kuotë deri në 700 metra mbi nivelin e detit.

- **Klima**

Në territorin e rajonit mbizotëron klima mesdhetare, ka fusha pjellore, ka kodrina të ulëta, ka vargmale me lartësi mbi 700 m mbi nivelin e detit, ka pyje të dendur. Klima mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të freskët, është tipike për zonën fushore e kodrinore. Karakteristike për çdo stinë të vitit janë erërat e forta që fryjnë nga verilindja dhe lindja e drejtohen nga korridoret natyrore, shpatet e maleve. Nga pikëpamja e temperaturave vërehen amplituda të mëdha midis dimrit dhe verës. Temperatura mesatare vjetore është 15,6 gradë celcius, kurse amplituda mesatare është 18 gradë celcius. Reshjet në territorin e rajonit kanë një shpërndarje të pabarabartë. Sasia mesatare e reshjeve është 1350mm në vit. Në zonën malore, kryesisht aty ku bie dëborë në dimër, reshjet janë të pranishme edhe gjatë verës, kurse në zonën kodrinore dhe fushore vera është e thatë. Ditët me diell variojnë nga 220-240 dite, ku mesatarisht gjatë vitit ka deri 3000 orë diell.

- **Flora dhe Fauna**

Bimësia është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zona bimësie si zona e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi,

gështenja), e ahishteve (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas vetive të përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjeksore e aromatike që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca. Bimët mjekësore që rriten në këtë zonë janë: sherbela, trumza, kamomili, lulebliri, çaj mali, luleshtrydha, lulëkuqja, mullaga. Në zonën tonë rriten edhe bimët spontane foragjere me vlera ushqimore për bagëtinë. Në bimësinë e livadheve dhe kullotave mbizotërojmë graminoret dhe bishtajoret në gjendje të egër si: tërfili, grami, talla, shpatorja. Bimët endemike janë bimë që rriten vetvetiu brenda një territori të caktuar të kufizuar dhe rriten në vartësi të relievit e klimës. Fauna është zhvilluar në varësi të mjedisit. Kështu dallohen fauna tokësore, fauna e ujrave të ëmbla dhe fauna e egër. Shpendë të gjetisë janë rosa e pata e egër, thëllënxa, karabullakët, çapkat etj. Kafshë të egra që rriten në këtë zonë janë dhelpra, lepuri, ujku, ariu dhe derri i egër.

- **Gjeologjia dhe dherat**

Formësimi gjeologjik i përket periudhës së rrudhosjes alpine këtu e 225-milion vjet më parë. Në këtë strukturë gjeologjike ka shkëmbenj të shumtë sedimentarë, magmatike dhe metamorfikë me rezerva të pasura xeherorësh, bakri, kromi, silici, kuarci, kauline, gurë dekorativ e gëlqerorë, argjila, inerte etj. Me një traditë të hershme në përpunimin e tyre, të mjaftueshme për ngritjen e shumë aktiviteteve industrialo-ekonomike.



### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te aktivitetit.

#### **o Ndikimet ne popullsi**

Realizimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet aktiviteti.

#### **o Ndikimet ne toke**

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta te rrezikshme qe te demtojne mjedisin. Mbetje teknologjike fraksion i imet nga linja e inerteve qe varion 1- 5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar, mase e cila kalon me ujerat. Kjo mase pas dekantimit sistemohet dhe riperdoret nga zona. Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linje se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime.

#### **o Ndikimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur . Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte ber nje izolim ne pjesen e daljes se mases se bluar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me erë. Ne raste te tilla subjekti perdore sperkatjen me uje here pas here ndersa makinat transportuese jane te mbuluara. Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra , brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth.

#### **o Ndikimet ne ujera**

Ujerat industrial qe perdoren ne linjen e fraksionimit , orientohen me nje kanal siperfaqesor ne sistemin e vecante .Meqenese masa e perdorur eshte inerte, keto ujera nuk permbajne elemente qe mund te kontaminojne ujerat. Megjithate do te ndertohen gropa paradekantuese te mases se ngurte per te evituar derdhjet e mbetjeve te ngurta ne mjedisin ujqor prites.

○ *Ndikimet ne klime*

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

○ *Ndikimet ne floren dhe faunen*

Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kësaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushte me mjedisin rrethues ketu paraqet nje larmi biologjike te varfer, qe eshte po keshtu nje pasqyrim i gjendjes se ketij ekosistemi tashme te degraduar.

○ *Ndikimet nga zhurmat*

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe mulliri . Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Gjithashtu dhe makinerite e prodhimit te betonit emetojne zhurma por brenda normave te lejuara.

Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth.

#### **4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do te sigurohet marrja e masave si me poshte:

##### **Emetimet ne ajer**

Ne rast te kohes se thate me ere, siperfaqet perreth territorit ku do te zhvillohet aktiviteti, do te sperkaten here pas here me uje me qellim shmangien e emetimit te pluhurave ne ajer.

##### **Mbetjet e ngurta**

Mbetje teknologjike fraksion i imet nga linja e inerteve qe varion 1- 5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar, mase e cila kalon me ujerat. Kjo mase pas dekantimit sistemohet dhe riperdoret nga zona.Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linje se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime.

##### **Shkarkimet e ujerave**

Do te kontrollohen periodikisht dhe do te pastrohet grupa dekantuese. Meqenese masa e perdorur eshte inerte, keto ujera nuk permbajne elemente qe mund te kontaminojne ujerat.

##### **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe mulliri . Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Gjithashtu dhe makinerite e prodhimit te betonit emetojne zhurma por brenda normave te lejuara.

##### **Rastet aksidentale**

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne kantier do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

### **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do ti pajise me uniforma dhe mjete mbrojtese.

### **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes ne shoqeri do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerezve dhe mjedisin perreth.

### **KONKLUZIONE**

- Ky aktivitet prodhues nuk demton habitate dhe nuk prish ekuilibrat biologjike-natyrore.
- Prodhimi i mbetjeve te gurta eshte i vogel i pakonsiderueshem dhe do te mbahen nen kontroll dhe trajtimi i tyre do te behet konforme detyrimeve ligjore. Po keshtu clirimi i gazeve dhe pluhrave ne ambient do te mbahet ne kontroll te rrepte teknik.
- Zbatimi i masave te projektit per mbrojtjen e mjedisit dhe ato pak elemente ndotes qe kemi permendur me siper qe mund te kene ndikim te vogel ne ambient do te eliminohen.
- Do te ndihmoje ndertuesit me lende te pare asfalto-beton per shtrimin e rrugeve dhe objekteve te tjera te kesaj natyre.
- Mbajtja paster e mjedisit te zones se operimit, do te jete detyre e perhershme e subjektit per te garantuar nje mjedis te paster ne territorin e zones ku kryhet aktiviteti. Jane mbjelle peme perreth impiantit.
- Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe puntoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes.

### ❖ **REKOMANDIME**

Duke ditur se gjate proceseve te punes ne impiant çlirohen në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive, vibrim në afersi të makinerive për të rritur sigurinë në punë dhe cilesinë e jetës së punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

- Te kontrollohet periodikisht dhe te pastrohet grupa dekantuese. Mbetjet e ngurta qe ndodhen ne masen rreth 2% te perdoren per mbushje te territorit dhe krijimit te mjedisit te pershtatshem per mbjelljen e metejshme te pemeve dhe luleve.
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit si dhe te mjeteve te punes.
- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanel kulluse ne territor.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.

**Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k**

**Ing. Xhevair DERMYSHI**